# Fondacioni
# BOTA NDRYSHE

## KUSH JEMI NE

Themeluar në vitin 2014 me synim mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive kulturore, sociale, mjedisore dhe shkencore, në nivel lokal dhe kombëtar. Fonadiconi synon të jetë gjithmonë e më shumë aktiv në aktivitete, studime, hulumtime, materiale dhe dokumentacion në përputhje me standartet dhe vlerat evropiane. Bota Ndryshe është një fondacion privat, kulturor dhe jo-fitimprurës, i përkushtuar ndaj idealeve dhe vlerave themelore të demokracisë sociale, me seli në Tiranë, Shqipëri.

## FUSHAT E VEPRIMTARISE

- Sociale
- Art
- Kulture
- Dixhitalizim
- Inovacion
- Evente

## Qëllimi

- Të nxise dhe të çojë përpara interesat publike në kulturën dhe arsimin shqiptar, brenda vëndit dhe jashtë tij, duke inkurajuar dhe përhapur njohuri për traditat intelektuale, juridike dhe shkencore të Shqipërisë.

- Të organizojë dhe të mbështesë realizimin e veprimtarive kulturore, sociale, mjedisore e shkencore në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe të mbështesë individë, grupe individësh apo shoqata që veprojnë në këto fusha.

- Të kontribuojë në zgjidhjen e qëndrueshme të problemeve sociale, kulturore dhe mjedisore në Shqipëri.


- Të nxise dhe të çojë përpara interesat publike në kulturën dhe arsimin shqiptar, brenda vëndit dhe jashtë tij, duke inkurajuar dhe përhapur njohuri për traditat intelektuale, juridike dhe shkencore të Shqipërisë.

- Të organizojë dhe të mbështesë realizimin e veprimtarive kulturore, sociale, mjedisore e shkencore në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe të mbështesë individë, grupe individësh apo shoqata që veprojnë në këto fusha.

- Të kontribuojë në zgjidhjen e qëndrueshme të problemeve sociale, kulturore dhe mjedisore në Shqipëri.


## Kontakt


**Address:**
Kopshti botanik, pall. Fir. Brari, Shk. 1, Kati 4, Ap. 16, Tirana 1001.

**Phone:**
+355 698139419

**Email:**
botandryshe@gmail.com

**Web:**
www.botandryshe.com

# Projektet

Tirana Sessions
2017
Donatori: Bashkia Tiranë

Tirana Sessions Dhjetë Lokacione, Dhjetë Artistë, Një Qytet. Ne besojmë që muzika ka fuqinë të n'a bashkojë, të n'a lidhi dhe të krijoji ndryshim. "Tirana Sessions" është një lëvizje promovuese me të cilën këngëtarë të ndryshëm lidhin këngën dhe artin e tyre me disa nga lokacionet më interesante të qytetit tonë. Ne mendojmë se duke bashkuar këngën me Tiranën ndërlidhim të dy palet. Misioni jonë është promovimi i qytetit duke e lidhur atë me artistët që e karakterizojnë atë.
https://www.youtube.com/channel/UCCm-hoTDzMHXPGH9JfvCifA

Tirana Virtual Tour
2018
Donatori: Bashkia Tiranë

Projekti ka si synim reklamimin dhe promovimin e monumenteve të kulturës të Tiranës si dhe të thjeshtojë aksesin turistëve dhe qytetarëve duke i krijuar mundësinë e prekjes virtuale me audio, foto, video 360 GRADE të monumeteve dhe rrethinave. U krijuan 32 video 360 grade në të cilat kushdo mund të prekë 15 monumentet nga afër dhe mund të shikojë cfare ka rrotull, në të njejtën kohë videot kanë opsionin VR dhe smartphone 3d, pra do të mund të shihen dhe me syze dixhitale dhe me smartphone.
http://tiranavirtualtour.al/

Tirana e Vjetër dhe e Re
2018
Donatori: Bashkia Tiranë

Projekti ka si synim të sjelli në menyra artistike historikun e Tiranës duke e dixhitalizuar atë me matching apps në menyrë që kalimtaret në periudhen festive të fundvitit, që postojnë foto e video me smartphones ta kenë më të aksesueshem historikun e Tiranës dhe në menyra dixhitale dhe artistike. Synimi I projektit është krijimi dhe montimi I disa tabelave në një instalacion në të cilin të jenë foto të tiranës së vjetër me moment historike të clirimit. 8 xhamat pra 8 ngjarjet do të kenë një QR code nga i cili me celular po ta scannosh do të coje në një faqe tv pergatitur nga ne në të cilen del historia e eventit në fjalë.
http://tiranapitstop.com/

Albanian Virtual Tour
2019
Donatori:
Ministria e Kulturës

Projekti ka si synim reklamimin dhe promovimin e monumenteve të kulturës si dhe të thjeshtojë aksesin turistëve dhe qytetarëve duke i krijuar mundësinë e prekjes virtuale (me audio, foto, video 360, VR) të monumeteve dhe rrethinave. Duke u konsultuar me Ministrinë e Kulturës do të krijojmë një mini historik për cdo monument i cili do të lexohet dhe regjistrohet në studio profesionale nga narrator profesionist në dy gjuhe, anglisht dhe shqip. Përshkrimi historik do të lexohet nga narrator në mënyrë që të krijojmë spote audio për monumentet në fjalë që do të shërbejnë si një audiobook.
http://albaniavirtualtour.al/

Lapidari i Ri
2020
Donatori: Bashkia Tiranë

Mendojmë që duke krijuar një itinerar të ri për tek Lapidari dhe duke e kthyer Lapidarin në pikën e re për të gjithë njerëzit pasionant të vrapit, hiking dhe ecjes së lehtë do të ndihmojmë dhe në zhvillimin e potencialit ekonomik-social të zonës.Objektivat e projektit janë të përmirësojmë përvojën e përgjithshme të vrapuesëve dhe sportistëve në zonën në fjalë duke pastruar itinerarin, me stola e tabela orjentuese, shkalle druri në terrenin malor, instalacionin për foto në majë. Me synim te bëjme "Cool" Lapidarin. Risitë që krijon Lapidari I Ri, rezultojnë në rritjen e përvojës së turistëve në zonë dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore përmes teknologjisë smart.
http://tiranavirtualtour.al/lapidari-shtegu-i-eger/

Vendose Maskën
2020
Donatori: AMSHC

Fushata sensibilizuese ka si qëllim kryesor sensibilizimin e njerëzve ndaj maskës dhe ndaj udhëzimeve. Arti dhe Kultura mund jetë në plan të dytë për shkak të shpërthimit të koronavirusit por kjo nuk i ndalon artistet të frymëzuar dhe nga fushata Online e NBA të përdorin shtrirjen e tyre masive në internet për efekt të mirë duke edukuar ndjekësit online për rreziqet e covid 19. Tetë Artistë VIP do të perdorin instagramin e tyre për të promovuar mesazhet dhe udhezimet në menyrë që tësensibilizojnë ndjekesit e tyre.

Tirana #IS
2021
Donatori: Bashkia Tiranë

Projekti konsiston në një fushate online brenda dhe jashte Shqipërisë dhe konkretisht në krijimin e 5 videove të cilat do të simoblizojnë fushat: Diversitet, Biznes, Sport, Kulture, Jetesen 24/7.
Ne jemi me fat që jetojmë në një vend kaq të gjallë. Tirana është plot histori dhe mundësi. Nga gjërat e vogla, në të mëdha; nga parku juaj lokal në Parkue Liqenit, nga shoku juaj I lagjes e deri tek partneri I biznesit ne Bllok! Le të themi së bashku - unë, ti dhe mijëra të tjerë - se pavarësisht Covid, Tirana do të jetë gjithmonë e hapur për botën, krenare për diversitetin tonë dhe gjithëpërfshirëse. Projekti u zhvillua gjatë verës 2021 në menyrë që të shërbej dhe si simboli i hapjes së Tiranës post Covid 19.
www.youtube.com/channel/UClFQAMtPj0JNRuz3Hnh6orQ

Kurset Youth
2022
Donatori: KRK

Tirana Youth Academy është një projekt për trajnime profesionale, i fokusuar në përgatitjen e studentëve për të qenë konkurent në një treg punësimi gjithnjë e më të specializuar. 18 të rinj trajnohen në fushat Audio, Video, Web Design ne studio profesionale. Perfituesit kryesor të ketij projekti janv të rinjtë të cilët trajnohen nga profesioniste të fushave të ndryshme, perfitues jane edhe vetë kompanitë te cilat do te trajnojnë dhe do të kenë mundesi të njihen me njerez potencial që në të ardhmen edhe mund t'i punesojnë.
https://tiranayouthacademy.com